

V E N D I M

Nr. 817, datë 28.12.1998

PËR PËRDORIM FONDESH BUXHETORE PËR BLERJE BANESASH

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nga fondet e buxhetit të shtetit të vitit 1998 miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit për zërin “investime në banesa”, të përdoren 44.52 milionë lekë për blerje banesash në tregun e lirë për familjet e pastreha në masën dhe kategoritë e mëposhtme:

- a) 17.12 milionë lekë për qytetarët me statusin e pastrehë dhe të përndjekurit politikë;
- b) 17.12 milionë lekë për familjet me aktmarrëveshje të pazbatuara me organet e pushtetit lokal;
- c) 10.28 milionë lekë për qytetarët e pastrehë me statusin e të pastrehë dhe të verbrit e grupit të parë.

2. Përdorimi i fondeve të mësipërme të bëhet nëpërmjet blerjeve nga tregu i lirë i banesave nga ana e vetë qytetarëve, që përfitojnë sipas shkronjave “a”, “b”, dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, mbështetur në listat nominale dhe strukturat e apartamenteve tip që përfitojnë, të hartuara nga Instituti i të Përndjekurve Politikë, Shoqata e të Verbërve, bashkia e Tiranës dhe të miratuara nga organet e pushtetit lokal.

3. Enti Kombëtar i Banesave, bazuar në listat nominale nga institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi kryen veprimet financiare me pronarët-shitës të banesave, vetëm pas paraqitjes dhe verifikimit të dokumentacionit ligjor përkatës, që vërtetojnë kryerjen e aktit të blerjes së banesave nga qytetarët, që e përfitojnë atë sipas këtij vendimi.

4. Enti Kombëtar i Banesave, sipas listave të shoqëruara me strukturat përkatëse, vë në dispozicion të secilit qytetar masat limit të përfitimit falas:

- a) Për apartamente (1+1) shumën prej 1.14 milionë lekë;
- b) Për apartamente (2+1) shumën prej 1.43 milionë lekë;
- c) Për apartamente (3+1) shumën prej 1.66 milionë lekë.

Këto shuma limit, të cilat do të indeksohen me vlerën e koeficientit “k”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 5.1.1998 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “k””, të përballohen nga buxheti i shtetit.

5. Kur shuma e vënë në dispozicion të qytetarëve, sipas pikës 4 të këtij vendimi, e indeksuar dhe me koeficientin “k” rezulton më e madhe se vlera e tregut, atëhere qytetari nuk do të përfitojë më shumë se vlera e tregut.

6. Fondi prej 44.52 milionë lekësh të kalojë në llogari të veçantë në Bankën e Kursimeve për t'u përdorur nga Enti Kombëtar i Banesave, për familjet e pastreha që përfitojnë sipas këtij vendimi.

7. Qytetarëve që përfitojnë sipas këtij vendimi, kur nuk kryejnë veprimet për blerjen e banesave brenda një afati prej 4-muajve nga momenti i vënies në dispozicion të fondeve përkatëse, u humbet e drejta e përfitimit si familje të pastreha.

8. Ngarkohen Ministria e Financave, Enti Kombëtar i Banesave, Pushteti Lokal, Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë dhe Shoqata e të Verbërve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko